



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1049/25, Datë 05.09.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baqelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 141 të mbajtur më datë 21.08.2025 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet** kërkesa e Fakultetit të Studimeve Islame (tutje FSI) me Nr.877/25 datë 16.07.2025 për zgjatjen e periudhës së riakreditimit për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2025 - 30 shtator 2026) për programin e studimeve:
Teologji Islame, BA 240 ECTS;
- II.** Zgjatja e periudhës të riakreditimit bëhet me kushtet dhe kriteret e njëjta të përcaktuara me vendimin e KShC-së Ref.: 929/22 datë 15.07.2022.
- III.** Fakulteti i Studimeve Islame mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të vendimit KShC-së Ref.:929/22 datë 15.07.2022 dhe të këtij vendimi.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Fakulteti i Studimeve Islame, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) Nr.877/25 datë 16.07.2025 për zgjatjen e periudhës së riakreditimit për një (1) vit akademik (nga 1 tetor 2025 - 30 shtator 2026) për programin e studimit:

- 1. Teologji Islame, BA 240 ECTS;**

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 141-të, të mbajtur më datë 21.08.2025 ka shqyrtuar kërkesën dhe duke u bazuar në arsyeshmërinë e kërkesës, në të cilën FSI ka ofruar: dëshmi faktike dhe juridike me të cilat ishte akredituar/riakredituar programi i studimit.

Kërkesa është bërë për vazhdimin e akreditimit të programit të studimit deri më 30 shtator 2026, bazuar në vendimin e më parshëm të KShC-së Ref.:929/22 datë 15.07.2022 të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Referuar vendimit të KShC, nr. 728/25, dt.20.06.2025 si dhe bazuar mbi Ligjin Nr.08/1-110, të AKA, neni 27 paragrafi 3 i cili parasheh se: *"Në rast se institucionet publike të arsimit të lartë aplikojnë për akreditim ose riakreditim të ndonjë programi studimor i cili me vendim të Qeverisë ose në bazë të ndonjë dokumenti strategjik shtetëror vlerësohet si program me interes nacional mund të akreditohet nga KShC me kusht për një periudhë një (1) vjeçare..."*

Në kuptim të kësaj dispozite, KShC ka marr për bazë Shkresën mbështetëse të MASHTI-t Nr.prot.01-3089 Dalje date 13.08.2025, Ref.01-135, në përkrahje të këtij programi, ka konstatuar se programi në fjalë konsiderohet si interes nacional bazuar në *"Strategjinë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit të Republikës së Kosovës 2023-2028"*.

Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizimit, ndër të tjera parasheh: *"Zhvillimin e programeve të veçanta në nivelin universitar, për identifikimin e rrethanave që qojnë në ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizëm që shpie në terrorizëm."*

KShC konsideron se FSI si i vetëm bartës i arsimit të lartë në Kosovë që ofron studime islame, ofron programe studimore të cilat trajtojnë dhe zbatojnë këtë element të rëndësishëm të kësaj strategjie, duke u vlerësuar kështu si programe me interes nacional.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 141 të mbajtur më datë 21.08.2025, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin relevant të FSI dhe duke u bazuar në kërkesën, dispozitat ligjore të lartës cekura dhe kompetencat, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Shkencave Islame;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.